



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 307, datë 06.06.2023

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Mirë”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Mirë”.
 2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmbja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*”– “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në vijim, po analizojmë mënyrën se si janë evidentuar këto elementë në vendimet burim vlerësimi për gjyqtarin {...}.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...Ai ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 2 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtari {...} kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile objekt shqyrtimi gjyqësor (shih dosjen 5) si dhe cilësimin e veprës (shih dokumentin 1-3, si dhe dosjet 1-3). Identifikon rastet kur, për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen, duhen njohuri të posaçme, duke thirrur ekspertët e fushës dhe duke parashtruar pyetje të qarta për ta (dosja 5). Zbaton me korrektësi procedurën e gjykimit të

shkurtuar (shih dokumentin 3 dhe dosjet 1-3). Ka njohuri të masave alternative të dënimit me burgim, identifikon rastet kur mund të vihet në zbatim pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim (shih dosjen 3). Zgjidh drejt çështjet penale në gjykim dhe për pasojë, në disa raste, palët nuk e kundërshtojnë vendimin e dhënë në gjykatat më të larta (shih dosjet 1-3). Në arsyetimin e vendimit në çështjen civile të analizuar nga subjekti nuk përdoren referenca ligjore materiale e procedurale civile dhe as në ligjin specifik “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe akteve nënligjore. Gjithashtu në çështjet penale në arsyetimin e vendimeve janë përdorur referenca në dispozitat përkatëse të ligjit material e procedural penal, por pa bërë ndonjë analizë juridike të tyre. Nga subjekti nuk përdoren në arsyetimin e vendimeve as referenca në praktikën e Gjykatës Kushtetuese apo vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë. Tre dokumentet e përzgjedhura prej tij dhe 5 dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë e tij mbi përgjegjësinë penale për veprat penale tënjohuri lidhur me vleftësimin dhe caktimin e masave të sigurimit...si dhe njohuri në fushën civile lidhur me regjistrimin e pronave të paluajtshme... ”.

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari përshkuan dhe analizon faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Karakteristikë e tij është prezantimi i rrethanave të çështjes në mënyrë koncize dhe të qartë, duke integruar provat dhe kur është e nevojshme edhe pjesë të përmbajtës së tyre, në funksionin të dhënies së një panorame të qartë për faktin objekt gjykimi.

Duke u nisur nga mënyra se si janë inkorporuar rrethanat e çështjes pothuajse në të gjitha vendimet e nënshtruara kësaj analize, vlen të theksohet se pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil apo penal*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar në gjykimet penale*), rrethanat e faktit parashtrihen në fillim të pjesës përshkruese - arsyetuese të vendimit dhe dominojnë përmbajtjen e gjithë vendimit gjyqësor në raport me komponentët e tjerë të arsyetimit.

Në disa prej vendimeve burim vlerësimi, para pjesës përshkruese – arsyetuese të vendimit, pozicionuar para kërkimeve përfundimtare të palëve, gjyqtari referon elementët më karakter procedural lidhur me zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit dhe procedimin me gjykim të shkurtuar, duke referuar edhe nenet respektive (*nenin 403 dhe 404 të K.Pr.P*) lidhur me gjykimin e shkurtuar dhe arsyen e pranimit të kërkesës së të pandehurit për procedimin me këtë formë të gjykimit¹.

Kujdesi që gjyqtari duhet të tregojë për përcaktimin e vlerës provuese të provave si dhe analizën e tyre në mënyrë të integruar, në raport me njëra - tjetrën, për të mbështetur konkluzionet mbi faktin penal/civil objekt shqyrtimi, nuk rezulton i dukshëm në çdo vendim burim vlerësimi. Në përgjithësi nga ana e gjyqtarit bëhet një paraqitje përshkruese e faktit penal ose civil objekt gjykimi, referohet në përmbajtjen e provave të administruara në mënyrë të drejtpërdrejtë por nuk

¹ Vendimi nr. 534, datë 06.05.2016, vendimi nr. 1099, datë 16.11.2015, vendimi nr. 582, datë 09.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

rezulton në çdo rast një analizë e integruar e tyre me njëra tjetrën dhe përcaktimi i vlerës provuese në funksion të provueshmërisë së faktit për të cilin referohen.

Nga të gjitha burimet e vlerësimit, vetëm në dy vendime civile² dhe në tre vendimet penale të zgjedhura nga gjyqtari³ për vlerësim, analiza e provave dhe përcaktimi i vlerës provuese të tyre është një element që ka marrë rëndësi të posaçme në arsyetim. Në vendimet penale të referuara kjo analizë bëhet në funksion të përcaktimit të elementëve të veprës penale dhe cilësimit juridik të saj, përgjegjësinë penale të të pandehurit në përputhje me provat e marra në shqyrtim si dhe një analizë e detajuar e veprimeve dhe mosveprimeve të të pandehurit në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim me qëllim përcaktimin apo jo të përgjegjësisë penale si dhe përcaktimin e elementëve cilësueses të tillë siç është kryerja e veprës penale në bashkëpunim⁴. Në vendimet civile burim vlerësimi, paraqitja dhe analiza e provave të administruara, duke referuar edhe pjesë të përmbajtjes së tyre, bëhet në funksion të përcaktimit të natyrës së kërkimit objekt padie dhe bazueshmërisë së tij në raport me të drejtën e pretenduar nga pala paditëse.

- Identifikimi i natyrës së çështjes

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjykata krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile apo penale. Gjithashtu gjykata pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike në mënyrë të shprehur ose të nënkuptuar, referuar analizës juridike të faktit me ligjin, përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile apo llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri në çështjet penale.

Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve, pavarësisht se në mënyrë jo të shprehur, i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarit, pasi pothuajse në të gjitha vendimet burim vlerësimi (*si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale*) në pjesën e parë përshkruese arsyetuese, duke analizuar faktet e çështjes dhe objektin e kërkimit në shqyrtim, natyra juridike e çështjes rezulton e qartë referuar identifikimit të elementeve dhe kriterëve ligjore të mosmarrëveshjes juridike në çdo vendim gjyqësor burim vlerësimi. Nuk rezulton që në vendimet gjyqësore burim vlerësimi natyra juridike e çështjes të jetë analizuar nga gjyqtari në funksion të përcaktimit të kompetencës në lëndë dhe funksion të gjykatës, por nga ana tjetër nuk konstatohen raste kur çështje të kompetencës janë ngritur nga palët apo kryesisht nga gjykata për vlerësim.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me

² Vendimi nr. 2490, datë 30.10.2013 dhe vendimi nr. 11-2013-4861, datë 17.10.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

³ Vendimi nr. 534, datë 06.05.2016, vendimi nr. 1099, datë 16.11.2015, vendimi nr. 582, datë 09.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

⁴ Vendimi nr. 534, datë 06.05.2016, vendimi nr. 1099, datë 16.11.2015, vendimi nr. 582, datë 09.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari në përgjithësi identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, kjo referuar edhe natyrës së çështjes ku në disa raste, identifikimi i normës relevante për zgjidhjen e mosmarrëveshjes nuk rezulton që të jetë përcaktuar në mënyrë të shprehur.⁵ Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e problemeve dhe situatave procedurale, konstatohet se:

(i) Në vendimet civile (me objekt anulim akti, njohje vjetërsie në punë dhe saktësim i vendndodhjes së pronës), gjyqtari nuk ka identifikuar në pjesën përshkuese arsyetuese ligjin procedural dhe/ose material të aplikuar në zgjidhjen e çështjes. I vetmi referim ligjor është ai i nenit 93 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar, referuar në kuadër të konkluzionit lidhur me plotësimin nga ana e paditëses të viteve të vjetërsisë në punë, pas njohjes së tyre nga gjykata⁶.

(ii) Në vendimet penale, gjyqtari në të gjitha vendimet e themelit burim vlerësimi identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, ashtu edhe dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në lidhje me individualizimin e dënimit apo institutin e bashkëpunimit. Konkretisht:

- a) identifikon nenet respektive të pjesës së posaçme të Kodit Penal, në përmbajtje të konkluzionit të tij lidhur me cilësimin juridik të faktit penal objekt akuze dhe përcaktimit të autorësisë së të pandehurit, duke referuar nenin 78, pg 1 të K. Penal, nenin 278/2 të K. Penal⁷; nenin 283, pg 2 të K. Penal⁸; nenin 139 të K. Penal⁹; nenin 278, pg 3¹⁰ dhe nenin 274 të K. Penal¹¹; nenin 199/a, pg 2 të K. Penal¹²; nenin 291¹³ dhe nenin 273 të K. Penal¹⁴; nenin 134 të K. Penal¹⁵ dhe nenin 242 të K. Penal¹⁶;
- b) identifikon nenin 25 të K. Penal në lidhje me institutin e bashkëpunimit¹⁷;
- c) identifikon nenet 49¹⁸, 48, shkronja ç)¹⁹, 51²⁰ në lidhje me rrethanat rënduese dhe lehtësuese që mbahen në konsideratë në përcaktimin e masës së dënimit, apo përcaktimin e masës së dënimit për të pandehurin e mitur;

⁵ Shih për më tepër vendimet civile nr. 2490, datë 30.10.2013 dhe vendimi nr. 11-2013-4861, datë 17.10.2013 në të cilët gjyqtari nuk rezulton të ketë referuar dhe as analizuar më pas ligjin material dhe/ose procedural të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes

⁶ Vendimi nr. 2490, datë 30.10.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

⁷ Vendimi nr. 582, datë 09.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

⁸ Vendimi nr. 1099, datë 16.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

⁹ Vendimi nr. 534, datë 06.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

¹⁰ Vendimi nr. 136, datë 17.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

¹¹ Vendimi nr. 132, datë 13.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

¹² Vendimi nr. 206, datë 25.02.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

¹³ Vendimi nr. 233, datë 12.03.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

¹⁴ Vendimi nr. 11-2015-2823, datë 12.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

¹⁵ Vendimi nr. 11-2015-6184, datë 21.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

¹⁶ Vendimi nr. 11-2014-4754, datë 27.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

¹⁷ Vendimi nr. 534, datë 06.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

¹⁸ Vendimi nr. 582, datë 09.06.2014, vendimi nr. 534, datë 06.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

¹⁹ Vendimi nr. 1099, datë 16.11.2015, vendimi nr. 132, datë 13.02.2014, vendimi nr. 206, datë 25.02.2016, vendimi nr. 233, datë 12.03.2015, vendimi nr. 136, datë 17.02.2014, vendimi nr. 11-2015-2823, datë 12.06.2015, vendimi nr. 11-2015-6184, datë 21.12.2015, vendimi nr. 11-2014-4754, datë 27.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

²⁰ Vendimi nr. 136, datë 17.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

- d) identifikon nenin 59 të K. Penal në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurit në provë, në kuadër të vlerësimit mbi aplikimin e këtij instituti²¹;

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, gjyqtari ka referuar në çdo rast dispozita të ligjit procedural penal (*nenet 403 - 406 të K.Pr.Penale*) në lidhje me procedurën e gjykimit të shkurtuar dhe uljen e masës së dënimit për shkak të aplikimit të këtij instituti. Në vendimin penal me objekt “Vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi”, gjyqtari ka referuar në arsyetim nenin 259, pika 3 të K.Pr.P në funksion të konkluzionit të tij mbi vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë²².

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar ndonjë rast konflikt i normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, pasi rezulton se gjyqtari në përgjithësi, por kryesisht tek vendimet penale, ka aftësi të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e natyrës së mosmarrëveshjes si dhe identifikimit të normës/normave konkrete, kryesisht atyre me karakter material, që gjejnë zbatim në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes/çështjes. Ndërsa në pjesën tjetër të vendimeve (kryesisht vendimet civile), identifikimi dhe përcaktimi i ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes nuk rezulton të jetë referuar në arsyetimin e vendimit. Po ashtu, në paraqitjen e fakteve të çështjes, dominon përshkrimi i fakteve dhe jo në të gjitha rastet rezulton të jetë bërë një analizë e vlerës provuese të provave mbi të cilat mbështeten fakteve përkatëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Mbi mesataren”, duke u pikëzuar me 20 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

²¹ Vendimi nr. 233, datë 12.03.2015, vendimi nr. 136, datë 17.02.2014, vendimi nr. 11-2015-2823, datë 12.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

²² Vendimi nr. 11-2014-83, datë 08.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet në të njëjtën mënyrë si në treguesin më sipër (*1.a.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave*).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet burim vlerësimi, aty ku është identifikuar norma juridike²³ (*kryesisht ato penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, referimi apo citimi i normës bëhet në mbështetje të konkluzionit të arritur nga gjyqtari mbi ekzistencën e faktit penal, cilësimin juridik të tij dhe përgjegjësinë e të pandehurit, apo në funksion të aplikimit të rrethanave lehtësuese ose rënduese në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit ose aplikimit të dënimeve alternative, por nuk rezulton që këto dispozita ti nënshtrohet një analizë apo zbërthimi paraprak, para përfshirjes së tyre në konkluzionin e arritur nga gjyqtari. Pothuajse në të gjitha vendimet penale burim vlerësimi, normat ligjore thjesht referohen, pa u shoqëruar me interpretimin e tyre, por bëhet aplikimi i tyre direkt mbi faktet e çështjes.

Konkretisht, në vendimet penale burim vlerësimi, gjyqtari referon dhe aplikon normën ligjore mbi faktet e çështjes, pa bërë paraprakisht zbërthimin e saj sipas elementëve të figurës së veprës penale, apo kushteve dhe kriterëve të aplikimit të një instituti të pjesës së përgjithshme të K. Penal, sikurse është ai i bashkëpunimit apo aplikimit të pezullimit të ekzekutimit dhe vënies së të pandehurit në provë, të cilët janë aplikuar në vendimet burim vlerësimi, pavarësisht se e shqyrton në tërësi çështjen. Pothuajse në të gjitha vendimet penale të themelit, për të mbështetur konkluzionin mbi llojin dhe masën e dënimit, gjyqtari referon nenet 48 dhe 49 të K. Penal në lidhje me rrethanat rënduese ose lehtësuese konkrete të rastit, apo nenin 59 në lidhje me aplikimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, por në asnjë rast nuk rezulton që këto dispozita ti jenë nënshtuar një interpretimi apo zbërthimit të kuptimit të tyre, para aplikimit mbi faktin konkret.

Në vendimet civile burim vlerësimi, në kushtet kur konstatohet mungesa e identifikimit dhe referimit të normës ligjore relevante për zgjidhjen e çështjes, rrjedhimisht nuk rezulton të ketë as interpretim të ligjit por çështja është zgjidhur duke referuar dhe analizuar vetëm faktet e saj.

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, nuk rezulton të ketë interpretim të tyre por, në disa nga vendimet penale burim vlerësimi në të cilat është proceduar

²³ Pasi ashtu sikundër e kemi cituar edhe më sipër, në vendimet civile burim vlerësimi nuk rezulton që të jetë identifikuar asnjë dispozitë relevante për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

me gjykim të shkurtuar, gjyqtari përfshin në konkluzionin e tij mbi pranimin e kërkesës për procedim me këtë lloj të posaçëm gjykimi, vetëm referimin e dispozitave, pa bërë një vlerësim mbi kushtet e zbatimit të tyre²⁴.

- *Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante*

Në tërësinë e vendimeve të analizuara, nuk rezulton në asnjë rast që gjyqtari të ketë identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit material dhe zbatimin e tij.

- *Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës*

Konstatohet se në vendimet burim vlerësimi, gjyqtari nuk përmend por zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, duke iu referuar kontekstit të arsytimit dhe konkluzionit të arritur, të tilla si parimi i humanizmit në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit, parimi i procesit të rregullt ligjor në drejtim të garantimit të të drejtave procedurale të palëve në gjykim, etj.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi nën mesatare në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Interpretimi i ligjit procedural dhe atij material në zgjidhjen e çështjes është tepër i kufizuar dhe në disa raste mungon. Në shumicën e vendimeve burim vlerësimi dispozitat referohen dhe zbatohen drejtpërdrejt në mbi faktet e çështjes, pa u bërë më parë një interpretim paraprak i tyre në drejtim të identifikimit të qëllimit, elementëve përbërës dhe zërthimit të tyre. Gjithashtu, nuk evidentohet në asnjë rast identifikimi dhe referimi në praktikën gjyqësore relevante, çka do ti jepte vlerë të shtuar interpretimit të ligjit, në mbështetje të konkluzioneve të arritura mbi zbatimin e tij. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit në tërësi, rezulton se interpretimi dhe analiza e normave nuk reflekton një shkallë të lartë kujdesi në të gjitha vendimet pasi gjyqtari kryesisht referon dhe aplikon drejtpërdrejt ligjin mbi faktet e provuara në gjykim, duke integruar referimin e dispozitave në konkluzionet e arritura, por nuk ndalet në interpretimin e ligjit dhe dhënien e arsyeve konkrete për mënyrën e zbatimit të tyre mbi faktet e çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Nën Mesatare” duke u pikëzuar me 10 pikë.

²⁴ Vendimi nr. 534, datë 06.05.2016, vendimi nr. 1099, datë 16.11.2015, vendimi nr. 582, datë 09.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Karakteristikë e këtij subjekti është që vendimi origjinal i tij i bërë më dorëshkrim, i cili zbardhet më pas nga sekretarja gjyqësore....”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë lehtësisht të lexueshme edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër. Gjyqtari respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së gjuhës së përdorur në arsyetimin e vendimit gjyqësor.

Në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, veç pjesës hyrëse dhe përshkruese arsyetuese të vendimit, evidentohet se në dispozitivin e vendimit gjyqtari është shprehur në mënyrë të plotë dhe koncize gjitha kërkimet, shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit, duke u bazuar tek gjuha e përdorur në të shkruar. Mënyra e zgjedhjes dhe përdorimit të fjalëve dhe organizimin i arsyetimit të vendimit gjyqësor, në drejtim

të shprehurit me gjuhë të thjeshtë dhe koncize i bën vendimet ato qarta dhe të kuptueshme për lexuesin.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRË ORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ -së lidhur me këtë tregues, konkludohet se :”...Struktura është e qëndrueshme, e standardizuar dhe subjekti i rivlerësimit duhet që përdor të njëjtën strukturë në hartimin e vendimit...”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion jo vetëm të orientimit të lexuesit por edhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të njëjtë, të cilës i përmbahet në prezantimin dhe analizën e fakteve dhe lidhjen e tyre me konkluzionin e tij mbi zgjidhjen e çështjes, por nuk rezulton që pjesë e strukturës së vendimeve burim vlerësimi, në shumicën e tyre, të jetë interpretimi dhe analiza e ligjit të zbatueshëm, para apo gjatë aplikimit të tij mbi faktet e çështjes konkrete. Gjyqtari ka një metodologji të qartë duke iu referuar pjesëve përbërëse të vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Konkretisht në mënyrë më specifike konstatohet se:

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti/akuza ndaj të pandehurit, si dhe kërkimet përfundimtare të subjekteve të pranishme në proces. Në disa vendime, në pjesën hyrëse të tyre evidentohet edhe procedura e posaçme e ndjekur për gjykimin e çështjes, sikurse është ajo e aplikimit të gjykimit të shkurtuar, duke referuar edhe bazën ligjore të aplikueshme për këtë lloj të posaçëm gjykimi²⁵.

Pjesa përshkuese arsyetuese është e ndarë në disa pjesë (*por jo të përcaktuara me tituj por të nënkuptuara referuar përmbajtjes së tyre*) në të cilët gjyqtari analizon:

- (i) *rrethanat e faktit*. Rezulton që prezantimi i faktit është i qartë dhe konciz si dhe referon në provat e administruara dhe të marra në shqyrtim.
- (ii) *paraqitjen e konkluzionit* lidhur me zgjidhjen e çështjes dhe konkretisht në lidhje me a) ekzistencën dhe provueshmërinë e faktit penal, kualifikimin ligjor të tij dhe autorësinë e të pandehurit, në vendimet penale, duke u paraqitur kjo pjesë e arsyetimit me një ose dy paragrafë; b) bazueshmërinë ose jo të kërkimeve të palës paditëse në çështjet civile burim vlerësimi, duke u paraqitur kjo pjesë në formën e konkluzionit të shkurtër, në fund të pjesës arsyetuese të vendimit.
- (iii) *paraqitjen e rrethanave që ndikojnë në përcaktimin e dënimit*. Në vendimet penale të themelit, gjyqtari në pjesën e fundit të arsyetimit referon rrethanat që ndikojnë në përcaktimin dhe individualizimin e dënimit si dhe aplikimin e dënimeve alternative, kur është rasti.

Referuar strukturës dhe përmbajtjes së arsyetimit të vendimit, rezulton se në arsyetimin e vendimit nuk elaborohet mjaftueshëm dhe nuk zë vendin e duhur në përmbajtje vlerësimi dhe analiza juridike e çështjes, pjesë në të cilën do të duhet të merrej në analizë ligji i zbatueshëm, zbërthimi i tij, mënyrë e aplikimit mbi faktet e çështjes, për të derivuar në tej në konkluzionin e arritur për zgjidhjen e çështjes, të cilin gjyqtari e paraqet në çdo vendim, menjëherë pas përshkrimit të faktit objekt gjykimi.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës në lidhje me deklarin fajtor të të pandehurit apo caktimin e masës së sigurimit, masën e dënimit aplikimin e gjykimit të shkurtuar, mënyrën e vuajtjes së dënimit, shpenzimet gjyqësore, e drejta e ankimit si dhe vendi dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet se në çështjet e kategorisë “*penale themeli*”, vendimet përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 383/ç të K.Pr.Penale, të ndryshuar. Në pjesën e dispozitivit në vendimet civile gjen pasqyrim disponimi i gjykatës në lidhje me pranimin e kërkesë padisë, shpenzimet gjyqësore e drejta e ankimit si dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet se në pjesën e dispozitivit vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile.

²⁵ Vendimi nr. 534, datë 06.05.2016, vendimi nr. 1099, datë 16.11.2015, vendimi nr. 582, datë 09.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të njëjtë të vendimit sipas pjesëve përbërëse të tij. Në të gjitha vendimet e analizuara, ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre. Por nga ana tjetër në strukturën e pjesës arsyetuese, kalimi nga analiza e fakteve të çështjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë në konkluzionin e arritur për zgjidhjen e çështjes, pa referuar dhe analizuar ligjin e aplikueshëm, ndikon në qartësinë dhe plotësinë e vendimit, pavarësisht se në dukje aspekti strukturor i ndërtimit të tij duket i qartë, por nuk mund të vlerësohet në të njëjtën mënyrë edhe për plotësinë e tij. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit nuk vlerësohet vetëm në aspektin formal të saj, por në thelb duhet të evidentohet edhe në aspektin përmbajtësor, ku një strukturë e qëndrueshme dhe e mirë organizuar duhet të përmbajë të gjithë elementët e saj, në funksion të qartësisë, plotësisë, qëndrueshmërisë dhe kuptueshmërisë së aktit si dokument ligjor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Mbi mesataren” duke u pikëzuar me 8 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GjEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.²⁶

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

²⁶ Vendimi i GjEDNJ, çështja *Hadjanastassiou kundër Greqisë*, dt. 16.12.1992, fq. 33.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme....Në përmbajtjen e vendimit nuk rezulton analizës së kërkimeve të palëve dhe dhënia e përgjigjeve për to, qoftë në rastet kur janë pranuar ose jo. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja mes fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve, ndonëse shumica e dosjeve penale janë me gjykim të shkurtuar, prej subjektit nuk i kushtohet ndonjë rëndësi e posaçme analizës së normës ligjore konkrete, prej tij nuk përdorën referenca nga praktikën e Gjykatës së Lartë si dhe praktikën e GJEDNJ. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respektin standardin e procesit të rregullt ligjor. Ai i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë me shkak ligjor e përgjithësisht me bazë ligjore.....Ndonëse nuk ka patur vonesa në arsyetimin e vendimeve, duke qenë i përpiktë në zbatimin e procedurës penale apo civile, cilësia e arsyetimit të vendimit të tij është në nivelin mesatar....”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Burimet e vlerësimit, referuar kategorisë dhe objektit të mosmarrëveshjes apo çështjes së trajtuar, lidhur me cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, paraqesin karakteristika të ndryshme.

Në vendimet penale, në përgjithësi gjyqtari nuk i ka kushtuar një rëndësi të posaçme analizës së faktit dhe provave të administruara në gjykim, por mungon edhe përqasja e kësaj analize me ligjin e zbatueshëm, në drejtim të kualifikimit ligjor të faktit penal, përcaktimit të vlerës provuese të provave apo elementë të tjerë të rëndësishëm të cilat duhet të çojnë në mënyrë logjike dhe të natyrshme tek konkluzioni që arrin dhe paraqet gjyqtari mbi zgjidhjen e çështjes. Nuk rezulton e njëjta shkallë e vëmendjes sikurse për faktin penal, në drejtim të analizës dhe interpretimit të ligjit dhe dhënies së arsyeve mbi mënyrën e aplikimit të tij mbi faktin konkret, duke u mjaftuar me paraqitjen e konkluzionit se bazuar mbi këto prova dhe fakte, i pandehuri ka konsumuar veprën penale për të cilën ai akuzohet, por pa dhënë argumente se si është arritur në këtë konkluzion.

Në të njëjtën mënyrë, në pjesën e fundit të vendimeve penale të themelit, në lidhje me dënimin, vlerësimin e llojit dhe masës së dënimit apo aplikimin e dënimeve alternative, gjyqtari i ka kushtuar rëndësi analizës së faktorëve të posaçëm që ka konsistuar në aplikimin e instituteve respektive, por nuk rezulton të ketë marrë në analizë kushtet ligjore për përcaktimin dhe individualizimin e dënimit apo për aplikimin e dënimeve alternative, duke i integruar ato me rrethanat konkrete të çështjes, në mënyrë që të evidentohen arsytet mbi konkluzionin e arritur lidhur me përshtatshmërinë e masës së dënimit apo aplikimin ose jo të alternativave të dënimit me burgim.

Në vendimet civile, gjyqtari nuk evidenton në mënyrë të qartë normën ligjore të zbatueshme, duke bërë kryesisht analizën mbi çështjen në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi faktin dhe provat. Edhe në këto vendime, konkluzioni i paraqitur në fund të pjesës arsyetuese mbi zgjidhjen e çështjes, nuk është paraprirë nga arsytet dhe mënyrën e aplikimit të ligjit mbi faktin e provuar në gjykim.

Duke iu referuar vendimeve burim vlerësimi në tërësinë e tyre, nuk rezultojnë që, referuar natyrës komplekse ose jo të çështjes, gjyqtari të jetë ndalur në analizën e ndonjë instituti të caktuar të së drejtës, kur kjo rezultojnë e nevojshme, duke e bazuar marrëdhënien shkak- pasojë në marrëdhëniet juridike civile dhe lidhjes shkakësore të faktit penal në çështjet penale, në një lidhje të drejtpërdrejtë të vlerësimit të tij mbi faktin me konkluzionin e arritur, pa bërë një lidhje të natyrshme dhe të argumentuar mbi këtë raport logjik.

Në drejtim të gjithëpërfshirjes, gjyqtari nëpërmjet vlerësimit të tij mbi zgjidhjen e çështjes, jo gjithmonë i ka dhënë përgjigje pretendimeve të palëve²⁷. Në shumicën e vendimeve nuk rezultojnë që te jetë ndalur në mënyrë specifike në analizën e tyre, duke bërë një analizë e mirëfilltë ligjore mbi këto kërtimeve, e cila të jetë pjesë e procesit logjik nëpërmjet të cilit gjyqtari ka arritur tek bindja e formuar.

KONKLUZIONI

Analiza dhe argumentimi logjik mbështetet kryesisht në analizën dhe vlerësimin e gjyqtarit mbi faktet e çështjes, duke bazuar konkluzionin për zgjidhjen e çështjes si deduksion të kësaj analize, por pa integruar dhe mbështetur këtë të fundit në interpretimin dhe dhënien e argumenteve mbi mënyrën e aplikimit të ligjit mbi faktin konkret. Analiza jo e plotë, e detajuar dhe e integruar e provave në raport me ligjin e zbatueshëm, me qëllim evidentimin e faktit penal apo civil, nuk i jep cilësi të lartë analizës dhe argumentimit logjik. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, në raportin mes analizës së fakteve përballë ligjit të zbatueshëm dhe mënyrës së aplikimit të tij, rezultojnë se gjyqtari nuk ka treguar të njëjtën shkallë kujdesi në drejtim të analizës dhe argumentimit logjik. Procesi analitik i vlerësimit të provave dhe shkalla e interpretimit të ligjit të zbatueshëm edhe në drejtim të analizës së marrëdhënies shkak-pasojë, evidentojnë dukshëm një shkallë të ndryshme aftësie të gjyqtarit në lidhje me këtë tregues duke u dominuar vendimet burim vlerësimi nga elementi përshkruar në raport me atë analitik. Elementi gjithëpërfshirës i analizës së pretendimeve të ngritura nga të pandehurit në çështjet penale komplekse pothuajse mungon gjithashtu.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Nën Mesatare” duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”

Niveli i vlerësimit

²⁷ Referoju vendimeve të zgjedhura : Nr. 534 dt. 06.05.2016, ku nuk rezultojnë t'i jetë dhënë përgjigje pretendimit të ngritur për mungesën e bashkëpunimit; Nr. 1099 dt. 16.11.2015 ku nuk rezultojnë t'i jetë dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura për kryerjen e veprës penale sipas nenit 283/1 dhe jo 283/2 si dhe atij për moszbatimin e nenit 59 të K.Penal; Nr. 582 dt. 09.06.2014, ku nuk rezultojnë t'i jetë dhënë përgjigje pretendimit të ngritur për kryerjen e veprës në kushtet e tronditjes së forte psikike të çastit.

AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Mirë	63

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari {...} ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë (dosja 4) deri në 9 muaj e 23 ditë (dosja 5). Çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit 9 muaj e 23 ditë ka qenë çështje civile themeli, në përfundim të gjykimit është disponuar me vendim themeli për pranimin e padisë (dosja 5). Në tre dosjet e tjera kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 26 ditë (dosja 1), 1 muaj e 7 ditë (dosja 2) dhe 1 muaj e 8 ditë (dosja 3). Ndër këto 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se në 4 raste është respektuar afati standard i gjykimit (dosja 1,2,3 dhe 4), ndërsa në një rast afati standard i gjykimit prej 6 muaj është tejkaluar (dosja 5). Shkak për tejkalimin e afatit standard ka qenë sjellja e palëve në proces por edhe niveli i menaxhimit të çështjes nga vetë gjyqtari për disiplinimin e sjelljes së palëve, si dhe leja vjetore në muajin gusht. Sa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se ato kanë zgjatur 6 muaj e 4 ditë (dokumenti 1), 4 muaj e 1 ditë (dokumenti 2) dhe 4 muaj e 10 ditë (dokumenti 3).Gjykimi në të tre dokumentet ligjore ka përfunduar brenda afateve standard të Sistemit të Vlerësimit. ”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari dhe një çështje të trajtuar si pasojë e ankesave, të referuara për vlerësim etik dhe profesional sa i përket kohëzgjatjes së gjykimit, e cila i përket periudhës së vlerësimit 2013-2016.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Po kështu edhe për çështjet civile, në përgjithësi nuk parashikohet afat ligjor në Kodin e Procedurës Civile për përfundimin e tyre.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari dhe 1 çështje të trajtuar si pasojë e ankesave, të referuar për vlerësim etik dhe profesional sa i përket kohëzgjatjes së gjykimit, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se për dy prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e gjykimit. Konkretisht:

(i) Çështja e kategorisë «kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake» (*vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi*), për të cilën është parashikuar si afat ligjor afati 48 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykate, sipas nenit 259/5 të K.Pr.Penale. Referuar dosjes që i përket vendimit nr.(11-2014-83) 13, datë 08.01.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, rezulton se kërkesa ka si datë regjistrimi datën 07.04.2014 dhe datë vendimi datën 08.04.2014. **Rezulton që është respektuar afati ligjor 48 orë i parashikuar në nenin 259/2 të K.Pr.Penale për përfundimin e saj.**

(ii) Çështja e kategorisë «kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake», me objekt “Ankim ndaj vendimit për zgjatjen e afatit të hetimeve”, përfunduar me vendimin nr. 175, datë 18.01.2016²⁸, **rezulton të ketë përfunduar për një afat prej 4 muaj, ndërkohë që neni 325, pg 2 K.Pr.Penale²⁹, sipas formulimit të dispozitës në fuqi në kohën e zhvillimit të gjykimit, parashikonte afatin 10 ditore të gjykimit.** Referuar akteve të trajtimit të ankesës nga ish Inspektorati i KLD-së dhe vendimit të KPK nr. 143, datë 26.04.2019 në të cilin janë referuar shpjegimet e gjyqtarit, rezulton se kohëzgjatja e gjykimit është ndikuar nga mosparaqitja e avokatit mbrojtës të kërkuarve dhe vetë kërkuarve në tetë seanca³⁰.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar

²⁸ Çështja penale e analizuar në burimet arkivore të KLGJ/KLD dhe po ashtu e analizuar në vendimin e KPK, pasqyruar më sipër në këtë raport, e cila është referuar për vlerësim etik dhe profesional të gjyqtarit organi respektiv që ka trajtuar çështjen.

²⁹Në momentin e regjistrimit të çështjes dhe deri në datën që kjo çështje ka përfunduar, neni 325, pg 2 i K.Pr.P ka pasur këtë formulim :” 2. Ankesa shqyrtohet nga gjykata brenda dhjetë ditëve, duke u dëgjuar i pandehuri, mbrojtësi, i dëmtuari dhe prokurori.”

³⁰ Në vendimin e KPK me nr. 143, datë 26.04.2019, lidhur me këtë ankesë referohet se :” Në parashtrimet e tij subjekti pranoi se, gjykimi ka zgjatur për një periudhë 2/mujore, pra në tejkallim të afatit 10 ditore të gjykimit të parashikuar në nenin 325 të K.Pr.P, me sqarimin se avokati mbrojtës i ankuesve nuk është paraqitur në tre seanca, por vetëm në seancën e datës 18.01.2016, kur është dhënë vendimi dhe ka paraqitur (i) vendimin nr. (11-2016-180), 1/130/3, datë 18.01.2016, datë regjistrimi 18.11.2015; (ii) procesverbale të seancave gjyqësore datë 07.12.2015, 21.12.2015, 08.01.2016 dhe 18.01.2016, me të cilat vërtetohet se shtyrja e seancave gjyqësore ka ardhur për shkak të mosparaqitjes në gjykim të ankuesve dhe avokatit mbrojtës të tyre, dhe jo për shkaqe që varen nga subjekti.”

çështjeve të analizuar më sipër në të cilat për 2 (dy) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre dhe prej tyre një çështje ka përfunduar brenda afatit ligjor (48 orë sipas nenit 259 të K.Pr.Penale) ndërsa një çështje ka përfunduar tej afati ligjor 10 ditor të parashikuar nga neni 325, pg 2 K.Pr.Penale, rezulton se raporti i çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor në raport me numrin e përgjithshëm të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është 50 %.

Duke konsideruar natyrën e çështjes e cila është gjykuar tej afatit ligjor si dhe shkaqet që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e saj, të cilat lidhen kryesisht me sjelljen e palëve në proces (mosparaqitjen e prokurorit dhe mbrojtësit të zgjedhur), vlerësoj se kjo çështje duke qenë një çështje e vetme, nuk mund të konsiderohet si tregues i saktë dhe absolut mbi aftësinë e gjyqtarit për respektimin e afateve ligjore. Duke konsideruar veprimet procedurale dhe kohën e kryerjes së tyre, lidhur me shqyrtimin e çështjeve në kohë dhe duke respektuar afatin ligjor të gjykimit, në të dy çështjet e referuara më sipër, vlerësohet se aftësitë e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues janë të larta dhe një çështje, nuk mund të shërbejë e vetme si tregues për aftësinë e tij për respektimin e afateve ligjore.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuar për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore” gjyqtari pikëzohet 15 pikë pasi përbindja e çështjeve të gjykuara prej tij tej afatit ligjor, diktohet nga kohëzgjatja vetëm e një çështje, për gjykimin me efikasitet dhe në kohë të së cilës gjyqtari ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme, përveç atyre që lidhen me disiplinimin e sjelljes së palëve në proces, që kanë përbërë shkak për kohëzgjatjen e shqyrtimit të saj.*

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se nga ana e gjyqtarit janë respektuar standardet minimale kohore të gjykimit, duke

iu referuar të njëjtit konkluzion të cituar në treguesin më sipër, për shkak se analiza e kohëzgjatjes së gjykimit për çështjet me afat ligjor dhe standard minimal kohor është bërë së bashku në raport.³¹

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Për 10 nga çështjet e vëzhguara për të cilat nuk parashikohet afat ligjor gjykimi dhe 3 nga vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, në raport me standardet minimale kohore sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së³², rezulton si më poshtë:

Referuar 10 çështjeve të përzgjedhura me short, konstatohet se:

- (i) Në çështjen penale nr. 996 regj, datë regjistrimi 30.09.2014, ndaj të pandehurit T.R, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 291 i K. Penal, përfunduar me vendimin nr. 920, datë 27.10.2014, rezulton se gjykimi ka përfunduar për 27 ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj referuar vendimit 261/2 te ish KLD-së;
- (ii) Në çështjen penale nr. 1292 regj, datë regjistrimi 04.11.2015, ndaj të pandehurit A.M, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 134/1 i K. Penal, përfunduar me vendimin nr. 1250, datë 21.12.2015, rezulton se gjykimi ka përfunduar për 1 muaj e 17 ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj referuar vendimit 261/2 te ish KLD-së;
- (iii) Në çështjen penale nr. 630 regj, datë regjistrimi 04.05.2015, ndaj të pandehurit D.H, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 291 i K. Penal, përfunduar me vendimin nr. 549, datë 12.06.2015 rezulton se gjykimi ka përfunduar për 1 muaj e 8 ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj referuar vendimit 261/2 te ish KLD-së;
- (iv) Në çështjen civile nr. 129/4194 regj, datë regjistrimi 24.12.2012, me objekt “Saktësim i vendndodhjes së pronës...”, përfunduar me vendimin nr. 2402, datë 17.10.2013 rezulton se gjykimi ka përfunduar për 9 muaj e 23 ditë, pra jashtë standardit minimal kohor prej 6 muaj referuar vendimit 261/2 te ish KLD-së;
- (v) Në çështjen penale nr. 323 regj, datë regjistrimi 29.01.2016, ndaj të pandehurit A.B, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 199/a/2 i K. Penal, përfunduar me vendimin nr. 206, datë 25.02.2016 rezulton se gjykimi ka përfunduar për 27 ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj referuar vendimit 261/2 te ish KLD-së;
- (vi) Në çështjen penale nr. 377 regj, datë regjistrimi 13.02.2015, ndaj të pandehurit H.Ç, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 291 i K. Penal, përfunduar me vendimin nr. 233, datë 12.03.2015 rezulton se gjykimi ka përfunduar

³¹Shih konkluzionin e Raportit të Inspektoratit të KLGJ-së, cituar në treguesin më sipër.

³² Sipas vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “ *Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjyqimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si me poshtë: a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.” Gjykimet civile në Gjykatën e Shkallës së parë jo më tej se 6 muaj dhe 4 muaj gjykimet familjare me palë kundërshtare”*

- për 28 ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj referuar vendimit 261/2 te ish KLD-së;
- (vii) Në çështjen penale nr. 330 regj, datë regjistrimi 23.01.2014, ndaj të pandehurit A.Ç, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/3 i K. Penal, përfunduar me vendimin nr. 136, datë 17.02.2014 rezulton se gjykimi ka përfunduar për 28 ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj referuar vendimit 261/2 te ish KLD-së;
- (viii) Në çështjen civile nr. 2271 regj, datë regjistrimi 31.05.2013, me objekt “Anulimin e akteve administrative...”, përfunduar me vendimin nr. 2490, datë 30.10.2013 rezulton se gjykimi ka përfunduar për 6 muaj, brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj referuar vendimit 261/2 te ish KLD-së;
- (ix) Në çështjen penale nr. 2/913 regj, datë regjistrimi 23.12.2013, ndaj të pandehurit S.B, akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 278/3 dhe 274 i K. Penal, përfunduar me vendimin nr. 132, datë 13.02.2014 rezulton se gjykimi ka përfunduar për 1 muaj e 20 ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj referuar vendimit 261/2 te ish KLD-së;
- (x) Në çështjen penale nr. 1482 regj, datë regjistrimi 18.12.2015, ndaj të pandehurit E.Z, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 291 i K. Penal, përfunduar me vendimin nr. 160, datë 16.02.2016 rezulton se gjykimi ka përfunduar për 1 muaj e 28 ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj referuar vendimit 261/2 te ish KLD-së;

Referuar tre vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtari, konstatohet se:

- (xi) Në çështjen penale të përfunduar me vendimin nr. 582, datë 09.06.2014, ndaj të pandehurit L.K, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 78/1 në lidhje me nenin 25 dhe neni 278/2, rezulton se çështja është regjistruar në datë 05.12.2013. Gjykimi ka përfunduar për 6 muaj e 4 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.
- (xii) Në çështjen penale të përfunduar me vendimin nr. 1099, datë 16.11.2015, ndaj të pandehurit E.K, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 dhe neni 278/2, rezulton se çështja është regjistruar në datë 15.07.2015. Gjykimi ka përfunduar për 4 muaj e 1 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.
- (xiii) Në çështjen penale të përfunduar me vendimin nr. 534, datë 06.05.2016, ndaj të pandehurit S.G, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 139 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, rezulton se çështja është regjistruar në datë 24.12.2015. Gjykimi ka përfunduar për 4 muaj e 10 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 13 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër rezultoi edhe më sipër, rezultoi se vetëm një çështje civile ka përfunduar jashtë afatit standard minimal kohor prej 6 muajsh të parashikuar në vendimin 261/2 të ish KLD-së. Pra në total rreth 7 % të çështjeve janë jashtë afatit standard minimal kohor, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, gjyqtari pikëzohet në nivel maksimal për shkak se përqindja e çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohor rezulton vetëm 7 % dhe ndikohet nga vetëm një çështje gjyqësore, nga 13 të analizuara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej tij tej standardit minimal, është 7 %.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin e analizimit të aftësive profesional të Inspektoratit të KLD-së nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykatat e Shkallës së Parë në periudhën e vlerësimit.

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe një çështje të trajtuar si pasojë e ankesave, por për të cilën, sikurse u analizuar në treguesin “2.A.a Respektimi i afateve ligjore”, zbatohet afat ligjor gjykimi.³³

³³ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se: “Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.”

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për ç’do kategori çështjesh (*13 çështjet e marra në analizë 2 janë çështje civile themeli dhe 11 çështje penale themeli*), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 2 (dy) çështjet në kategorinë e çështjeve “civile me palë kundërshtare”, rezulton të jetë rreth 236 ditë ose **8 muaj dhe 8 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor prej 6 muaj** për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 11 (njëmbëdhjetë) çështjet në kategorinë e çështjeve “penale themeli”, rezulton të jetë **67 ditë ose 2 muaj e 7 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 9 muaj ose 12 muaj** për gjykimin e çështjeve të kategorisë “penale themeli” në Gjykatën e Shkallës së Parë.

Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjysmën e kategorive të çështjeve të analizuara. Në çështjet e kategorisë “penale themeli” kjo kohëzgjatje është dukshëm më e shkurtër se standardi minimal kohor i zbatueshëm ndërsa në kategorinë civile themeli (për 2 çështjet e analizuara) standardi minimal kohor është tejkaluar me 2 muaj e 8 ditë. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit kjo llogaritje matematikore nga e cila rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve, përkon me një pikëzim prej 3 pikësh. Por duke marrë në konsideratë faktin se (i) koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, vetëm për një kategori e cila në vetvete përbehet nga vetëm dy çështje, tejkalohet me rreth 2 muaj, (ii) ky tejkallim në vetvete ndikohet nga kohëzgjatja e gjykimit për vetëm një çështje të vetme e cila ka përfunduar për 9 muaj e 23 ditë, kohëzgjatje në të cilën përfshihet periudha e lejes vjetore të gjykatës (35 ditë) e cila nëse do të zbritet, kohëzgjatja rezulton 8 muaj e 8 ditë për këtë çështje, ndërsa për kategorinë respektive do të rezultonte rreth 7 muaj, dhe tejkallimi i saj me vetëm 1 muaj, si dhe (iii) duke iu referuar ecurisë procedurale të çështjes dhe shkaqeve që kanë ndikuar në shtyrjen e seancave dhe rrjedhimisht në kohëzgjatjen e gjykimit, të cilat lidhen me ecurinë procedurale të çështjes, njoftimet dhe kërkesat e palëve³⁴, vlerësohet se ky tregues duhet të pikëzohet maksimalisht me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Mbështetur në të njëjtën analizë si treguesi më sipër (*treguesi “2.A.b Plotësimi i standardevë minimale kohore.”*), rezulton se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është e lartë, pasi rezulton se vetëm për njërën nga 2/kategoritë e çështjeve, koha mesatare është më e gjatë se standardi minimal kohor, duke e tejkaluar këtë standard me 1 muaj, tejkallim i cili i referohet një çështje të

³⁴ Referuar dosjes gjyqësore dhe analizës së saj në Raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të përgatitur nga KLGJ me nr. 3578/5 prot., datë 14.02.2019, rezulton se seancat janë shtyrë për (i) përsëritjen e njoftimit për të paditurit, (ii) marrjen e një dosje civile nga arkiva e gjykatës, (iii) dhënien e kohës palëve për tu njohur me materialet e dosjes së tërhequr nga arkiva, (iv) me kërkesë të palës së paditur ZVRPP për të kryer verifikime në regjistrat e administruara prej saj, (v) për ti dhënë mundësi përfaqësuesit të palës së paditur për tu pajisur me akt përfaqësimi, etj.

vetme, ndërkohë që për të gjitha çështjet e tjera burim vlerësimi, rezulton se gjyqtari i ka përfunduar në një kohë dukshëm më të shkurtër se standardi kohor i aplikueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ -së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...} në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, Ai jep të dhëna që gjatë kësaj periudhe ka kryer detyrën e gjyqtarit duke punuar në fushën e të drejtës penale. Ai ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim në vitet 2014-2016 gjithsej 1356 çështje penale dhe ka përfunduar si kryesues 1517 çështje penale, duke mbartur në vitin e fundit 49 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve bazuar në këto të dhëna është 111.8 %. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata..... për efekte të organizimit të shortit konstatohet se në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016 gjyqtari {...} ka gjykuar 1245 çështje, nga të cilat 437 çështje penale themeli, 199 kërkesa penale dhe 535 masa sigurimi, si dhe 60 çështje civile administrative, 2 familjare dhe 2 kërkesa civile...”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016 gjyqtari ka përfunduar 1245 çështje, nga të cilat 437 çështje penale themeli, 199 kërkesa penale dhe 535 masa sigurimi, si dhe 60 çështje civile administrative, 2 familjare dhe 2 kërkesa civile. Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë së njëjtës periudhë kohore 08.10.2013-08.10.2016, mbetet e pamundur përlllogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe, për pasojë, do të merret i mirëqenë rendimenti 111.8 % i përcaktuar në faqen 31 të Raportit, i përlllogaritur me të dhënat statistikore për intervalin kohor 2014-2016, rendiment i cili përkon me nivelin e pikëzimit me 10 pikë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 111.8 %.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtari pikëzohet me 10 pikë, duke qenë se rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve është 111.8 %.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën 2013-2016, referuar të dhënave që përmbajnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar Raportit për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se: “Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë arsyetimi të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari {...} i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore. Konkretisht arsyetimi i vendimeve është kryer për 1 ditë nga shpallja (dosja 1), për 3 ditë nga shpallja (dosja 1 dhe 2), për 5 ditë nga shpallja (dosja 3) dhe për 7 ditë nga shpallja (dosja 5). Në të 5 rastet arsyetimi ka qenë brenda afatit ligjor, brenda afatit 5 ditor për çështjet penale dhe brenda afatit 10 ditor për 1 çështje civile. Ndonëse nuk ka pasur vonesa në arsyetimin e vendimeve duke qenë i përpiktë në zbatimin e procedurës penale apo civile, cilësia e arsyetimit të vendimeve të tij është në nivel mesatar.”

Në Kodin e Procedurës Penale, para ndryshimeve me ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor të ankimit sipas nenit 415 të K.Pr.P, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Në këto kushte në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10/ditor i ankimit ndaj vendimit penal dhe afati 15/ditë i ankimit ndaj vendimit civil të gjykatës së shkallës së parë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

- (i) Në çështjen penale që i përket vendimit nr.(11-2014-83) 13, datë 08.01.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt “Vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi”, rezulton se dosja gjyqësore dhe vendimi përfundimtar është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 09.01.2014, **1 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (ii) Në çështjen penale me nr. 1292 regj, datë regjistrimi 04.11.2015, ndaj të pandehurit A.M, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 134/1 i K. Penal, përfunduar me vendimin nr. 1250, datë 21.12.2015, rezulton se dosja gjyqësore dhe vendimi përfundimtar është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 24.12.2015, **3 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (iii) Në çështjen penale me nr. 630 regj, datë regjistrimi 04.05.2015, ndaj të pandehurit D.H, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 291 i K. Penal, përfunduar me vendimin nr. 549, datë 12.06.2015, rezulton se dosja gjyqësore dhe vendimi përfundimtar është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 17.06.2015, **5 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (iv) Në çështjen civile nr. 129/4194 regj, datë regjistrimi 24.12.2012, me objekt “Saktësim i vendndodhjes së pronës...”, përfunduar me vendimin nr. 2402, datë 17.10.2013, rezulton se dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 24.10.2013, **pra 7 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (v) Në çështjen penale me nr. 996 regj, datë regjistrimi 30.09.2014, ndaj të pandehurit T.R, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 291 dhe 242 i K. Penal, përfunduar me vendimin nr. 920, datë 27.10.2014, rezulton se dosja gjyqësore dhe vendimi përfundimtar është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 30.10.2014, **3 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (vi) Në çështjen penale me nr. 323 regj, datë regjistrimi 29.01.2016, ndaj të pandehurit A.B, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 199/a/2 i K. Penal, përfunduar me vendimin nr. 206, datë 25.02.2016, rezulton se dosja gjyqësore dhe vendimi përfundimtar është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 02.03.2016, **5 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

- (vii) Në çështjen penale me nr. 377 regj, datë regjistrimi 13.02.2015, ndaj të pandehurit H.Ç, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 291 i K. Penal, përfunduar me vendimin nr. 233, datë 12.03.2015, rezulton se dosja gjyqësore dhe vendimi përfundimtar është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 20.03.2015, **8 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (viii) Në çështjen penale me nr. 330 regj, datë regjistrimi 23.01.2014, ndaj të pandehurit A.Ç, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/3 i K. Penal, përfunduar me vendimin nr. 136, datë 17.02.2014, rezulton se dosja gjyqësore dhe vendimi përfundimtar është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 20.02.2014, **3 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (ix) Në çështjen penale me nr. 2/913 regj, datë regjistrimi 23.12.2013, ndaj të pandehurit S.B, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 274 dhe 278/3 i K. Penal, përfunduar me vendimin nr. 132, datë 13.02.2014, rezulton se dosja gjyqësore dhe vendimi përfundimtar është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 17.02.2014, **4 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (x) Në çështjen penale me nr. 92/1482 regj, datë regjistrimi 18.12.2015, ndaj të pandehurit E.Z, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 291 i K. Penal, përfunduar me vendimin nr. 160, datë 16.02.2016, rezulton se dosja gjyqësore dhe vendimi përfundimtar është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 19.02.2016, **5 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (xi) Në çështjen civile nr. 2271 regj, datë regjistrimi 31.05.2013, me objekt “Anulim akti...”, përfunduar me vendimin nr. 2490, datë 30.10.2013, rezulton se dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 05.11.2013, pra **6 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit (i) për kategorinë *kërkesa penale të hetimit paraprak*, për një dosje, është 1 ditë; (ii) për kategorinë *penale krime*, për 8 dosje është 4.5 ditë dhe (iii) për kategorinë *civile themeli*, për 2 dosje, është 6.5 ditë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve*”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje menjëherë me marrjen e akteve të çështjes me short, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Konkretisht në 2 raste ai ka vepruar brenda ditës së shortit (dosja 3 dhe 4), në 2 raste ka vepruar 1 ditë nga shorti (dosja 1 dhe 2) ndërsa në një rast ka vepruar pas 3 ditëve nga shorti (dosja 5). Në një çështje civile të vëzhguara ai ka kryer veprimet përgatitore të cilat janë dokumentuar rregullisht në procesverbal (dosja 5). Megjithatë në këtë rast efektiviteti i veprimeve përgatitore nuk ka qenë në nivelin e dëshiruar pasi gjatë gjykimit pala ka paraqitur kërkesa procedurale që duhet të ishin zgjidhur në veprimet përgatitore dhe që kanë penguar produktivitetin e seancave gjyqësore, siç është kërkesa për ekspert topograf e bërë në seancën e 10 gjyqësore. Në 5 çështjet e vëzhguara gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë (dosja 4), me 3 seanca (dosja 1), me 4 seanca (dosja 2 dhe 3), me 16 seanca (dosja 5). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 28 seanca gjyqësore nga të cilat 18 kanë qenë produktive. Pengesë për 10 seancat gjyqësore ka qenë mungesa e gjyqtarit, për shkak të qenies në konferencë gjyqësore (1 seancë), kërkesa e prokurorit për konkluzionet me shkrim (3 seanca), kërkesë për shtyrje e palës paditëse (3 seanca), kërkesë për shtyrje e avokaturës së shtetit (2 seanca) dhe mungesa e autorizimit të përfaqësuesit të palës së paditur (1 seancë)...”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, 10 prej tyre vlerësohen si çështje me palë kundërshtarë për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të

gjqtarit, me përjashtim të dosjes nr. 4, që i takon kategorisë *kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake*:

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjatë procedurës së rivlerësimit, është konstatuar se:

Gjyqtari {...} ka kryer veprimet e nevojshme me qëllim përfundimin në kohë të gjykimit të çështjeve. Pas marrjes së çështjes me short ai i ka vënë në lëvizje shpejt përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore dhe njoftimin e palëve brenda afatit 10 ditor të përcaktuar nga neni 333 i K.Pr.Penale si dhe nenit 155 të K.Pr.Civile. Gjyqtari ka disponuar me vendim formal për kalimin e çështjes për veprime përgatitore në çështjet civile apo seancë gjyqësore për çështjet penale. Ndër 10 çështjet e vëzhguara, rezulton se :

- *Çështja penale që i përket vendimit nr.920, datë 27.10.2014 ka përfunduar me 3 seanca;*
- *Çështja penale që i përket vendimit nr.1250, datë 21.12.2015 ka përfunduar me 4 seanca;*
- *Çështja penale që i përket vendimit nr.549, datë 12.06.2015 ka përfunduar me 4 seanca;*
- *Çështja civile që i përket vendimit nr.2402, datë 17.10.2013 ka përfunduar me 14 seanca;*

Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

- *Çështja penale që i përket vendimit nr.206, datë 25.02.2016 ka përfunduar me 2 seanca;*
- *Çështja penale që i përket vendimit nr.233, datë 12.03.2015 ka përfunduar me 2 seanca;*
- *Çështja penale që i përket vendimit nr.136, datë 17.02.2014 ka përfunduar me 2 seanca;*
- *Çështja civile që i përket vendimit nr.2490, datë 30.10.2013 ka përfunduar me 7 seanca;*
- *Çështja penale që i përket vendimit nr.132, datë 13.02.2014 ka përfunduar me 5 seanca;*
- *Çështja penale që i përket vendimit nr.160, datë 16.02.2016 ka përfunduar me 4 seanca;*

Në dosjet penale të vëzhguara rezulton se gjyqtari relator i ka vënë në lëvizje çështjet në një kohë shumë të shkurtër nga caktimi i tyre me short duke caktuar seancën e parë gjyqësore konform nenit 333 të K.Pr.Penale dhe duke urdhëruar njoftimin e palëve për ditën dhe orën e gjykimit. Aktet e njoftimit, së bashku me shkresat për shoqërimin e të pandehurit, kur është rasti, si dhe njoftimin për organin e akuzës janë pjesë e dokumentacionit të dosjes. Në këto çështje shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ardhur për shkaqe procedurale të tilla si (i) pranimi i kërkesës së prokurorit ose mbrojtjes për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim; (ii) caktimin dhe prezencën e psikologut në rastet kur i pandehuri ka qene i mitur; (iii) për të siguruar prezencën e të pandehurit në gjykim duke urdhëruar ri thirrjen e tij; (iv) njoftimin e avokatit të caktuar kryesisht; (v) njoftimin dhe përsëritjen e njoftimit për të pandehurin nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore. Gjyqtari është kujdesur për planifikimin dhe shtyrjen e seancave gjyqësore brenda afatit procedural 15/ditor të parashikuar në nenin 342/2 të K.Pr.P dhe masat e marra prej tij për të siguruar zhvillimin e seancës vijuese, nëpërmjet njoftimeve dhe shkresave respektive, përgjithësisht rezulton të kenë qenë korrekte dhe efektive.

Në dosjen civile burim vlerësimi, e cila i përket vendimit me nr. 2490, datë 30.10.2013, rezulton se pas zhvillimit të veprimeve përgatitore në dy seanca, gjykimi ka përfunduar pas 7 seancash gjyqësore. Seancat gjyqësore janë shtyrë për shkaqe të tilla si : përsëritje e njoftimit për palën e paditur (1 seancë), thirrja dhe paraqitja e dëshmitarëve (1 seancë), pranimi i kërkesës së palës paditëse për paraqitjen e provave shkresore (2 seanca), dhënia e kohës palëve për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim (2 seanca). Pavarësisht numrit të seancave, rezulton se

gjqytari është kujdesur për caktimin e tyre brenda afateve të shkurtra dhe konkretisht nga 2 deri në 15 ditë, duke u kujdesur që në rastet e shtyrjes së seancës për t' i lënë kohë palëve për konkluzionet me shkrim, ky afat të mos jetë më i gjatë se afati 5 ditor i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.C.

Referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 10.5 seanca gjyqësore në çështjet civile me palë kundërshtare (duke përfshirur seancat përgatitore) dhe 3 (3.2) seanca gjyqësore në çështjet penale. Në total numri mesatar i seancave gjyqësore është 4.7 seanca për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Lidhur me kryerjen e veprimeve procedurale për shmangien e seancave jo produktive, rezulton se nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje civile dhe penale themeli) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal (*nenin 158/a dhe 171 e vijues të K.Pr.Civile dhe neni 333 e vijues dhe 342/2 të K.Pr.Penale*). Në çështjet penale data e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatet 10 ditore të përcaktuara në nenin 333 të K.Pr.Penale. Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Përgjithësisht shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si njoftimi i të pandehurve, njoftimi i mbrojtësve të të pandehurit, marrje e informacionit dhe provave nga të tretët, kryerja e akteve të ekspertimeve, njoftimi i ekspertit etj. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të neni 342/2 të K.Pr.Penale, por edhe në çështjet civile konstatohet se gjyqtari cakton përgjithësisht seanca të afërta në kohë nga njëra – tjetra jo më shumë se 15 ditë larg.

Megjithatë në 2 çështjet civile burim vlerësimi, rezulton se gjatë gjykimit janë kryer veprime procedurale për marrjen e provave nga të tretët, apo lënien e kohës palëve për të paraqitur prova shkresore të vlerësuara të rëndësishme për gjykimin, ndërkohë që këto veprime mund të ishin kryer gjatë përgatitjes së çështjet për gjykim në veprime përgatitore. Po ashtu në disa raste seancat gjyqësore janë shtyrë për të njëjtin shkak (*për dhënien e kohës palëve për të paraqitur prova apo për dhënien e kohës shtesë për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare*), pavarësisht se gjyqtari duket se ka marrë masat e nevojshme për përfundimin e gjykimit në një kohë të shkurtër, duke i caktuar seancat vijuese brenda afateve të shkurtra.

Në lidhje me shkallën e aftësisë së gjyqtarit për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, në lidhje me çështjen me nr. (7022-01608)159/2, datë regjistrimi 04.09.2015, me kërkesë shtetasin A.Ç, me objekt “Ankim kundër vendimit për zgjatjen e afateve të hetimit”, përfunduar me vendimin nr. 175, datë 18.01.2016. KPK në vendimin nr. 143, datë 26.04.2019, pasi analizon çështjen, konkludon se: “...Në parashtrimet e tij subjekti pranoi se, gjykimi ka zgjatur për një periudhë 2/mujore, pra në tejkallim të afatit 10 ditor të gjykimit të parashikuar në nenin 325 të K.Pr.P, me sqarimin se avokati mbrojtës i ankuesve nuk është paraqitur në tre seanca, por vetëm në seancën e datës 18.01.2016, kur është dhënë vendimi dhe ka paraqitur (i) vendimin nr. (11-

2016-180), 1/130/3, datë 18.01.2016, datë regjistrimi 18.11.2015; (ii) procesverbale të seancave gjyqësore datë 07.12.2015, 21.12.2015, 08.01.2016 dhe 18.01.2016, me të cilat vërtetohet se shtyrja e seancave gjyqësore ka ardhur për shkak të mosparaqitjes në gjykim të ankuesve dhe avokatit mbrojtës të tyre, dhe jo për shkaqe që varen nga subjekti.“.

Lidhur me ankesën e mësipërme për të cilën nga KPK është konkluduar se mosrespektimi i afatit ligjor të shqyrtimit të çështjes nuk ka ardhur për shkaqe që varen nga gjyqtari, në relacionin e inspektoreve dt. 29.01.2019, është konkluduar se : “pretendimi i ankuesve për zvarritje të gjykimit qëndron, pasi në rastin konkret rezultoi një periudhë prej 4 muaj e 14 ditë që ka vazhduar ky gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, është tepër në kapërcim të afatit 10 ditor të përcaktuar për këtë lloj gjykimi nga Kodi i Procedurës Penale. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga gjyqtari {...} në këtë rast nuk respekton standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ. Gjyqtari nuk ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme, për shqyrtimin brenda afatit të kërkesës ankimore, ndonëse zgjatja e afatit nga prokuroria ka qenë tre muaj. Pra shqyrtimi i kësaj kërkesë ankimore ka vazhduar edhe pas mbarimit të afatit të zgatur, duke zhvlerësuar qëllimin për të cilin ishte ushtruar kërkesa ankimore nga ankuesi. Nga analiza e zhvillimit të seancave gjyqësore rezultoi se pala ankuese nuk është paraqitur tre herë në gjykim, por edhe prokuroria si palë e interesuar nuk është paraqitur në katër seanca gjyqësore, duke sjellë si pasojë shtyrjen e seancave gjyqësore dhe zvarritjen e gjykimit. Janë zhvilluar 10 seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 2 kanë qenë produktive.....”

Referuar sa më sipër, për treguesin e “numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve³⁵ të përzgjedhura me short, rezultoi se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është mbi 3 seanca dhe gjyqtari jo në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive.

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, rezultoi se gjyqtari në çdo rast ka marrë të gjitha masat e nevojshme për planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë, por e njëjta shkallë aftësie nuk evidentohet për shmangien e seancave jo produktive e zhvillimin e gjykimit me efektivitet.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, numrit mesatar të seancave gjyqësore, 10.5 seanca gjyqësore në çështjet civile me palë kundërshtare (duke përfshirë seancat përgatitore) dhe 3

³⁵ Referuar Metodologjisë së Pikëzimit “Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përfshirë ato pa palë ndërgjyqëse”.

(3.2) seanca gjyqësore në çështjet penale dhe shkallës së kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproduktive, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet mesatare, sepse për çështjet civile, rezultojnë në mënyrë të përsëritur seanca të shtyra për të njëjtin shkak dhe moskryerje me efikasitet dhe veprimeve në seancë përgatitore. Ndërsa në çështjen penale me nr. (7022-01608)159/2, datë regjistrimi 04.09.2015, me kërkesë shtetasin A.Ç, me objekt “Ankim kundër vendimit për zgjatjen e afatave të hetimit”, përfunduar me vendimin nr. 175, datë 18.01.2016, evidentohet një numër i lartë seancash jo produktive (nga 10 seanca vetëm 2 produktive). Në këtë të fundit, pavarësisht nevojave procedurale që lidhen me ecurinë e gjykimit dhe pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit, rezulton se edhe pse vetë pala ankuese nuk është paraqitur tre herë në gjykim dhe prokurori katër herë në gjykim, gjyqtari veç përsëritjes së njoftimit për palët, nuk rezulton të ketë marrë masa për njoftimin e Drejtuesit të Prokurorisë, apo caktimin e një mbrojtësi kryesisht. Për këtë shkak, gjykimi i çështjes ka tejkaluar vetë afatin e zgjatur të hetimeve, çështja penale ndërkohë është dërguar për gjykimin në themel të saj dhe gjyqtari ka disponuar në fund me shpalljen e moskompetencës duke ia përcjellë atë për vlerësim gjyqtarit të themelit.

Veprimet procedurale të nevojshme sigurisht që kushtëzojnë shtyrjen e seancave gjyqësore, por nuk janë ato që drejtojnë gjyqtarin. Administruesi i procesit nuk është Kodi i Procedurës, ai është mjet në dorë të gjyqtarit, i cili duhet të përdoret në mënyrë efektive. Nga ana tjetër cilësia e zgjidhjes së çështjes, nuk është tregues i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit.

Tek kriteri i aftësive organizative, vlerësuesi nuk shqyrton ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjyqtarit në kuadër të procesit të rregullt ligjor, por aftësinë e gjyqtarit për të menaxhuar çështjen, në aspektin e përdorimit sa me efektiv të kohës dhe drejtimit të hetimit gjyqësor. Vlerësuesi nuk ndërhyr në çështje që lidhen me zbatimin e dispozitave procedurale në kuadër të procesit të rregullt ligjor. Sigurisht që ky i fundit nuk mund të përfundojë pa pasur një njoftim të rregullt të palëve, pa u respektuar e drejta e tyre për tu dëgjuar, apo për tu mbrojtur, sepse nëse këto të fundit nuk respektohen, potencialisht mund të shtrohen diskutime për shkelje disiplinore të gjyqtarit. Aftësia organizative e gjyqtarit shkon përtej kësaj. Gjyqtari duhet të organizojë procesin gjyqësor e të drejtojë hetimin gjyqësor, në zbatim të detyrimeve procedurale dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse, duke përfunduar shqyrtimin në një kohe sa më të shpejte, duke disiplinuar dhe vetë ai, me urdhra dhe vendime, sjelljen e palëve në gjykim. Në kohëzgjatjen e gjykimit, veç sjelljes së palëve, luan rol dhe mënyra se si gjyqtari drejton hetimin gjyqësor, duke iu dhënë zgjidhje pretendimeve të palëve **në momentin e duhur procedural**, pa shtyrë pafundësisht seancat gjyqësore, si në rastin konkret evidentohet në dosjet burim vlerësimi, ku seancat shtyhen disa herë për paraqitje provash apo për kryerje të aktit të ekspertimit, edhe pse nevojshmëria e marrjes së tyre ka qenë evidente që në fillim të gjykimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtari pikëzohet me 9 pikë.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Në përgjithësi orari i fillimit dhe i mbarimit të seancave gjyqësore është dokumentuar saktësisht në procesverbal (shih 5 dosjet). Nga vëzhgimi i tyre ka rezultuar se ka pasur vonesa të papërfillshme në fillimin e seancave gjyqësore nga orari i planifikuar nga 1 deri në 3 minuta. Ka pasur vetëm 1 seancë të filluar me 10 minuta vonesë dhe nga gjyqtari nuk është relatuar dhe dokumentuar shkaku i vonesës (dosja 1). Përgjithësisht gjyqtari {...} e ka respektuar solemnitetin duke zhvilluar gjykimin në sallë dhe duke i regjistruar audio seancat gjyqësore (dosjet 1-4). Nga analiza rezulton se vetëm në një çështje penale, vetëm një seancë është zhvilluar në sallë gjykimi me regjistrim audio ndërsa 3 seanca janë zhvilluar pa regjistrim audio (dosja 3). Gjithashtu bëjnë përjashtim edhe dy raste, një çështje penale dhe një çështje civile ku seancat janë pa regjistrim audio dhe nuk evidentohet nëse janë zhvilluar në zyrë apo sallë gjykimi (shih dosjet 2 dhe 5). Gjatë gjykimit gjyqtari {...} identifikon veprimet procedurale që duhet të kryhen dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara për realizimin e tyre dhe përgjithësisht me bazë ligjore. Distancat kohore midis seancave janë të arsyeshme dhe në raport me shkakun për të cilin seanca është shtyrë. ...Përgjithësisht ai ka monitoruar njoftimet e palëve për të shmangur vonesat në dërgimin e tyre apo për të siguruar zhvillimin korrekt të gjykimit dhe nuk ka pasur raste kur seanca ka dështuar për këtë shkak. Gjyqtari {...} zhvillon dhe dokumentin procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat procedurale që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve gjer në dhënien e vendimit përfundimtar. Pas çdo kërkesë apo hapi procedural merr rregullisht mendimin e të dyja palëve në gjykim. Përgjithësisht disponon me vendime të ndërmjetme për çdo veprim procedural të kryer gjatë gjykimit. Ai ka respektuar të drejtën e palëve për të siguruar mbrojtës dhe të drejtën për të marrë ekspert të fushës (dosja 5)...”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 10 prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve penale dhe civile me palë kundërshtare dhe 1 çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të fazës së hetimit paraprak.

Gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe vendim për caktimin e seancës gjyqësore menjëherë ose deri në 3 ditë pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve civile dhe penale. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore³⁶, ndërsa seancat përgatitore janë dokumentuar prej tij nëpërmjet mbajtjes së procesverbalit në mënyrë manuale.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*) ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*). Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*).

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje të vëzhguara, në përgjithësi seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa të papërfillshme që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit.

KONKLUZIONI

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe eficensës së treguar nga gjyqtari në kryerjen e veprimeve procedurale dhe fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

³⁶ Përveç disa seancave të evidentuara në dosjet e përzgjedhura gjatë procedurës së rivlerësimit, sikurse evidentohet ne Raportin përkatës të KLGJ-së, referuar më sipër në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar gjyqtari ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në rastet kur seanca nuk është çelur pasi mungon gjyqtari është mbajtur procesverbal administrativ nga sekretarja gjyqësore për të pasqyruar këtë fakt dhe për të njoftuar palët për seancën vijuese....”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin kronologjik, sipas datës së aktit. Renditja e akteve i bën dosjet gjyqësore lehtësisht të aksesueshme duke përmbajtur, (i) në çështjet civile aktin e shortit, kërkesë padia, aktet e përfaqësimit të palëve, provat e paraqitura nga ana e palëve ndërgjyqëse, njoftimet e palëve, diskutimet me shkrim të palëve, vendimin e kalimit të çështjes në seancë përgatitore, seancat përgatitore të zhvilluara sipas datave dhe me pas vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet, procesverbali i seancës përgatitore apo gjyqësore sipas datave, bashkë me njoftimet respektive, dhe vendimin përfundimtar të gjykatës; (ii) në çështjet penale dosja renditet duke filluar me aktin e shortit, vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, procesverbalet dhe njoftimet sipas datave, konkluzionet me shkrim të palëve dhe vendimi gjyqësor përfundimtar.

Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe në rend kronologjik, e bën dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet

paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëtuara dhe mund të shfrytëzohen pa vështirësi.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar si kërkesë padia apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim, konkluzionet e palëve apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat, etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e kateve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale. Në procesverbalet gjyqësore është pasqyruar ora e fillimit dhe përfundimit të seancës.”

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance përgatitore apo gjyqësore, shkresat drejtuar institucioneve ndihmëse, vendimi përfundimtar) si dhe aktet e paraqitura nga palët (aktet e përfaqësimit të palëve si prokura, autorizime, provat e administruara në të cilën përfshihet edhe akti i ekspertimit nëse është lejuar marrja e provës me ekspert, diskutimet përfundimtare të palëve). Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	94

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e KLGJ-së, konkludohet se: “Gjatë periudhës 3/vjeçare të rivlerësimit për gjyqtarin {...} janë paraqitur dy ankesa (në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së. Nga shqyrtimi administrativ i tyre, një ankesë është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se është ankesë e përsëritur më pare, një ankesë verifikuar për zvarritje gjykimi i

është regjistruar gjyqtarit për efekt të vlerësimit etik dhe profesional. Nga ana tjetër gjatë periudhës së rivlerësimit për gjyqtarin {...} gjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore...Së fundi duhet evidentuar se nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt...”

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale dhe akteve që lidhen me të dhënat arkivore të KLD-së, rezulton se gjyqtarit {...} i është regjistruar një ankesë e vitit 2016 për vlerësim etik dhe profesional. Kjo ankesë, sikurse është analizuar më sipër në burimet e vlerësimit konsiston në pretendime në lidhje me kohëzgjatjen gjyqimit për çështjen penale me nr. (7022-01608)159/2, datë regjistrimi 04.09.2015, me kërkuar shtetasin A.Ç, me objekt “Ankim kundër vendimit për zgjatjen e afateve të hetimit”, përfunduar me vendimin nr. 175, datë 18.01.2016³⁷. Kohëzgjatja e gjyqimit të kërkesës penale të përfunduar me vendimin nr. 175, datë 18.01.2016, me objekt “Ankim kundër vendimit për zgjatjen e afateve të hetimit”, duke qenë se i përket periudhës së vlerësimit 2013-2016 dhe në dosje administrohen të dhëna që bëjnë të mundur përlllogaritjen e kohëzgjatjes së gjyqimit dhe shkaqet që e kanë diktuar atë, përmban të dhëna burimore dhe është analizuar si burim vlerësimi në kriterin e aftësive organizative të gjyqtarit. Në drejtim të etikës në punë, nuk rezulton nga materialet e trajtimit të ankesës që të jenë evidentuar të dhëna burimore të cilat mund të vlerësohen për këtë kriter.

Referuar të dhënave të tjera nga burimet arkivore të KLD –së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Po ashtu në aktet e tjera të dosjes së rivlerësimit, përfshirë edhe vendimin e KPK nr. 143, datë 26.04.2019 në të cilin janë trajtuar dhe analizuar ankesat ndaj gjyqtarit, nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

Në tërësi, për periudhën e vlerësimit 2013 - 2016, nuk rezultojnë të dhëna që mund të analizohen dhe vlerësohen në drejtim të cenimit të etikës.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues vlerësohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

³⁷ KPK në vendimin nr. 143, datë 26.04.2019, pasi analizon çështjen, konkludon se: “...Në parashtrimet e tij subjekti pranoi se, gjyqimi ka zgjatur për një periudhë 2/mujore, pra në tejkalim të afatit 10 ditor të gjyqimit të parashikuar në nenin 325 të K.Pr.P, me sqarimin se avokati mbrojtës i ankuesve nuk është paraqitur në tre seanca, por vetëm në seancën e datës 18.01.2016, kur është dhënë vendimi dhe ka paraqitur (i) vendimin nr. (11-2016-180), 1/130/3, datë 18.01.2016, datë regjistrimi 18.11.2015; (ii) procesverbale të seancave gjyqësore datë 07.12.2015, 21.12.2015, 08.01.2016 dhe 18.01.2016, me të cilat vërtetohet se shtyrja e seancave gjyqësore ka ardhur për shkak të mosparaqitjes në gjykim të ankuesve dhe avokatit mbrojtës të tyre, dhe jo për shkaqe që varen nga subjekti. “.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarit në lidhje me treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e KLGJ-së, konkludohet se: “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ-së;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe figurës.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013- 8 tetor 2016”, për gjyqtarin {...} janë paraqitur gjithsej 2 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (të dy ankesat e i përkasin vitit 2016), të cilat pasi janë bashkuar, janë trajtuar nga Inspektorati dhe është konstatuar tejkalim i afatit ligjor të shqyrtimit të çështjes, sikurse është analizuar dhe konsideruar në treguesit respektive, më sipër. Nuk rezultojnë të dhëna për elementë të cenimit të integritetit të gjyqtarit në materialet e trajtimit të ankesave të bashkuara.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin {...} përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Nga vendimin e KPK-së me nr. 143, datë 26.04.2019, të korrigjuar me vendimin Nr. 4 dt. 15.05.2019, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, lidhur me kriteret e vlerësimit të pasurisë dhe figurës, konkludohet se “1. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, rezultoi se

subjekti i rivlerësimit, z. {...}, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas germës a, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016; 2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. {...}, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas germës b, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016; 3. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, kreut VI të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas germës c, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.”.

Më konkretisht në vendimin e korigjuar Nr. 4 dt. 15.05.2019, pjesë integrale e vendimit të KPK-së me nr. 143, datë 26.04.2019, në lidhje me kontrollin e figurës është konkluduar se: “...Gjatë hetimit administrativ, pas verifikimeve, është konstatuar plotësimi me saktësi i formularit për kontrollin e figurës, nga ana e subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë, nuk ka pasur të dhëna, informacione dhe dyshime për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo veprimtari korruptive nga subjekti i rivlerësimit”.

Sa më sipër, nuk rezulton që në procesin e rivlerësimit të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, të jenë vlerësuar të dhëna lidhur me integritetin e tij, të cilat mund të përbëjnë të dhëna burimore për vlerësimin e këtij treguesi në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të tij.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi.** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së konkludohet se: “Në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk evidentohen raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Për vetë gjyqtarin {...} në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Në tre raste konstatohet se gjyqtari është kujdesur për të pandehurin si individ në nevojë (ta pandehur pa mjete monetare) për ti siguruar mbrojtës (shih dosjet 1-3). Në një rast e ka marrë në konsideratë gjendjen e tij ekonomike në caktimin e llojit dhe masës së dënimit (shih dosjen 1). Në 3 dokumentet ligjore të paraqitura dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar çështje të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të

rivlerësimit. Po ashtu në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.”.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në 3 vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari dhe aktet e 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat statistikore.

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga KLGJ, lidhur me kërkesat për përjashtim, konstatohet se: *“Për vetë gjyqtarin {...} në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve.”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (*burimet arkivore të KLD/KLGJ*) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (*11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari*) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat e Ligjit për Statusin, zbatohen për aq sa është e mundur, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pa konsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Për këto arsye, për këtë tregues, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, vlerësohet si i pa konsiderueshëm.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.** Referuar sa më sipër, për treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “i pa konsiderueshëm”.*

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga KLGJ, lidhur me kërkesat për përjashtim, konstatohet se: *“Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari {...} komunikon me etike me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore qoftë në seancat gjyqësore. Ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore dhe gjyqësore ky shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe duke respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore) rezulton se gjyqtari, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (për marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve, marrjen e provave nga të tretët,

etj.) në aktet shkresore është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga KLGJ, nuk janë referuar të dhëna apo konsiderata lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e KLGJ-së konkludohet se: “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Ndonëse janë evidentuar raste që ka pasur vonesa të papërfillshme nga 1 deri në 3 minuta, dhe vetëm në një rast 10 minuta, në fillimin e seancave gjyqësore apo dështimin e seancave të planifikuara, këto nuk kanë ardhur për shkak të mungesës së bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Në asnjë rast nuk pa pasur vonesa në arsyetimin e vendimeve dhe bashkëpunimi i tij me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave apo të gjitha të dhënat e referuara në dokumentacionin e dosjes së rivlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, vlerësohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe prezumimit se mungesa e të dhënave për trajtimin pa respekt të punonjësve të administratës gjyqësore, keqtrajtimin e tyre nëpërmjet fjalorit të papërshtatshëm, përjashtimit social ...etj., vlerësohet si shkallë e lartë komunikimi dhe bashkëpunimi të gjyqtarit me administratën gjyqësore.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave të tjera për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën

gjyqësore, vlerësohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së me nr. 3578/5 prot., datë 14.02.2019 dhe të dhënave nga Shkolla e Magjistraturës, rezulton se gjyqtari {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese si me poshtë:

rezulton se gjyqtari {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese si me poshtë:

- (i) Aktiviteti me temë “Akuzat e reja”, zhvilluar në dat 29-30 prill 2014;
- (ii) Aktiviteti me temë “Drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi viktimë-kundërvajtës për të mitur”, zhvilluar në datë 17-18 dhjetor 2014;
- (iii) Aktiviteti me temë “Barazia gjinore dhe mos diskriminimi”, zhvilluar në datë 24 prill 2015.

Këto aktivitete përbëjnë gjithsej 5 (pesë) ditë trajnimi për periudhën 3/vjeçare të vlerësimit³⁸. Nuk rezultojnë të dhëna të tjera për angazhimin e gjyqtarit në trajnime dhe aktivitete

³⁸ Rezulton se gjyqtari ka paraqitur në formularin e vetëvlerësimit të aftësive profesionale edhe të dhëna për dy aktivitete të kualifikuara prej tij si specializime, të cilat shoqërohen me certifikatat përkatëse, ai më poshtë: (i) Trajnim në Institutin Ndërkombëtar të Studimeve të Larta në Shkencat Kriminale ISISC, Palermo, Siracuza, Itali në periudhën janar- shkurt 2000 dhe (ii) Specializim në Qendrën Kombëtare për Studime Gjyqësore, Kajro, Egjipt, në

profesionale, jashtë Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, nuk përmbante një parashikim lidhur me detyrueshmërinë e pjesëmarrjes së gjyqtarit në aktivitete trajnuese. Ndërkohë ky detyrim parashikohej në nenin 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas të cilit *gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.*

Aktualisht, në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 5 të tij, pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës është përcaktuar si e drejtë dhe njëkohësisht detyrim i gjyqtarit, duke përcaktuar edhe kufirin minimal dhe maksimal të pjesëmarrjes gjatë një viti si dhe gjatë pesë viteve³⁹. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues përcaktohet se *gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtari duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli. Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij që tregojnë ngritjen profesionale.*

Referuar sa më sipër, pavarësisht se ligji nr. 96/2016 dhe Metodologjia e Pikëzimit miratuar me vendimin nr. 264, datë 21.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk kanë qenë në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar nenit 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas formulimit të tij në periudhën e vlerësimit, rezultoi se pjesëmarrja e gjyqtarit në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës ka qenë e rregulluar nga ky ligj, duke përcaktuar vetëm kufirin maksimal të angazhimit për 1 dhe 5 vjet dhe jo një detyrim minimal pjesëmarrje apo kufirin minimal të angazhimit.

periudhën qershor – korrik 2000. **Të dy këto angazhime janë zhvilluar në vitin 2000 dhe nuk i përkasin periudhës së vlerësimit 2013-2016.**

³⁹ Në nenin 5 të Ligjit nr. 96/2016, parashikohet se :” 1. Magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit. 2. Magjistrati duhet: a) të ndjekë formimin vazhdues, në përputhje me legjislacionin në fuqi; b) të marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës. 3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve. 4. Magjistrati duhet të përmbushë detyrimin për të marrë pjesë në formimin vazhdues vetëm në ato raste kur programet e trajnimit janë: a) të përshtatshme për funksionin e tij; b) të organizuara dhe certifikuar nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli. Një kopje e certifikatës vendoset në dosjen personale të magjistratit.”.

Sa më sipër, referuar të dhënave lidhur me angazhimin e gjyqtarit {...} në aktivitete trajnuese brenda ose jashtë programit të formimit vazhdues të Sh. M, gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, pikëzimi për këtë tregues, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, do të jetë me 20 pikë, pavarësisht se për periudhën 3 vjeçare rezultoi të jetë angazhuar si pjesëmarrës vetëm në 3 aktivitete trajnuese, të shtrira në 5 ditë trajnimi sipas Rregullores së Shkollës së Magjistraturës. Kjo pasi legjislacioni i kohës parashikonte vetëm kufirin maksimal të pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese, por jo një kufi minimal pjesëmarrje, sikurse përcaktohet aktualisht në nenin 5, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke marrë në konsideratë frekuencën e angazhimit të gjyqtarit në aktivitete trajnuese, sipas të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, si dhe kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit, gjyqtari pikëzohet me 20 pikë.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, për treguesin “pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale jashtë saj”, gjyqtari pikëzohet me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezultoi se:

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, rezultoi se ai nuk është angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lektorit apo lehtësuesit në aktivitete trajnuese brenda Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Po ashtu nuk rezultojnë të dhëna të tjera për një angazhim të tillë jashtë këtij programi.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në

varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtarin {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në cilësinë e lehtësueses në disa aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lehtësues pranë Shkollës së Magjistraturës.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtari pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me këtë tregues.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...}, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndër institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtari pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me këtë tregues.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësoj se, për gjyqtarin {...}, ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë pikëzohet me 0 pikë.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtarit dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	91

NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Referuar nenit 78 të Ligjit për Statusin dhe Vendimit Nr.264 dt.21.11.2019 të KLGJ “ Metodologjia e Pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, niveli i përgjithshëm i vlerësimit përcaktohet si më poshtë :

Vlerësimi i gjyqtarit kryhet sipas këtyre niveleve:

- a) *Vlerësimi i përgjithshëm “shkëlqyeshëm” jepet në ato raste kur magjistrati është vlerësuar “shkëlqyeshëm” për të katërta kriteret.*
- b) *Vlerësimi i përgjithshëm “shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur magjistrati vlerësohet “shumë mirë” për tre kriteret dhe “mirë” për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit” duhet të jenë vlerësuar “shumë mirë”.*
- c) *Vlerësimi i përgjithshëm “mirë” jepet në rastin kur aftësitë e magjistratit vlerësohen “mirë” për dy kriteret dhe “mjaftueshëm” për dy kriteret e tjera. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur ka barazi në vlerësimin e kriterëve në nivelet “mjaftueshëm” dhe “i pamjaftueshëm”. Në çdo rast, kriteret “aftësitë gjyqësore” dhe “etika dhe përkushtimi ndaj vlerave të gjyqësorit” duhet të vlerësohen të paktën “mirë”.*
- d) *Vlerësimi i përgjithshëm “i pamjaftueshëm” jepet në këto raste:*
 - i. *kur magjistrati vlerësohet “i pamjaftueshëm” për të paktën në 3 kriteret;*
 - ii. *kur magjistrati vlerësohet “i pamjaftueshëm” për kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit” dhe jo më shumë se “mirë” për dy kriteret e tjera.*

Për çdo kombinim tjetër të ndryshëm nga ato të parashikuar më lart, niveli i përgjithshëm i vlerësimit do të përcaktohet në varësi të mesatares së pikëve të katër kriterëve, sipas shkallës së pikëzimit të përcaktuar në pikën 9 të kësaj metodologjie. Në çdo rast niveli i përgjithshëm i vlerësimit, nuk mund të jetë më i lartë, se niveli i vlerësimit për kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit”.

Niveli I vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	63	Mirë
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	94	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	348	Mirë

SHTOJCA 1

**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013 - 2016**

1. AFTËSITË PROFESIONALE				Piket total	Niveli i vlerësimit
				63	Mirë
Treguesit	Burimet	Niveli	Piket	Të dhëna për metodologjinë	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Mbi mesataren	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Nën mesataren	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsytimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Mbi mesataren	8	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së 	Nën mesataren	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë

		vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);			Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE				Piket total	Niveli i vlerësimit
				94	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	0-10 %	15	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve

					– 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	+99%	10	Tej standardit : Nën 81 % - 2 pikë Mbi 81-87 % - 4 pikë Mbi 87- 93 % - 6 pikë Mbi 93-99 % - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ul style="list-style-type: none"> b. Dosja e rivlerësimit; c. Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së 	Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e	9	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë

		vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	aftësisë		Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	c. Dosja e rivlerësimit; d. Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Piket total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	b. Dosja e rivlerësimit;	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit:

					E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	b. Dosja e rivlerësimit;	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarit : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	c. Dosja rivlerësimit;	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Piket total	Niveli i vlerësimit
				91	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas 	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë

		fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);			Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	15-120 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4

	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	<ul style="list-style-type: none"> Dosja e rivlerësimit; 	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	<ul style="list-style-type: none"> Dosja e rivlerësimit; 	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimi ligjore akademike	<ul style="list-style-type: none"> Dosja e rivlerësimit; 	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
NIVELI I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT		MIRË			
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		348			